

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MONITORIMIN, RAPORTIMIN DHE VERIFIKIMIN E SHKARKIMEVE TË GAZEVE SERRË NGA TRANSPORTI DETAR”

I. QËLLIMI I PROJEKT-AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim synon të krijojë një bazë ligjore të mirëpërcaktuar për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazeve serrë nga transporti detar. Rregullorja përcakton detyrime të drejtpërdrejta për të gjitha anijet që mbajnë flamurin shqiptar që mbërrijnë, ndodhen në ose nisen nga portet nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim garantimin e matjes së saktë të shkarkimeve të CO₂, CH₄ dhe N₂O dhe rritjen e transparencës mbi ndikimin e sektorit detar në ndryshimet klimatike. Projektakti synon krijimin e një sistemi të unifikuar kombëtar për mbledhjen, verifikimin dhe publikimin e të dhënave të sakta mbi shkarkimet e gazeve serrë nga anijet tregtare, forcimin e kapaciteteve të administratës detare për monitorim, raportim dhe verifikim në përputhje me kërkesat e Rregullores (BE) nr. 757/2015, nxitjen e reduktimit gradual të shkarkimeve përmes transparencës si dhe rritjen e sigurisë juridike për kompanitë detare duke përcaktuar qartë detyrimet, afatet dhe procedurat e raportimit dhe verifikimit. Këto objektiva kontribuojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e detyrimeve kombëtare për reduktimin e gazeve serrë, në përmirësimin e efikasitetit energjetik në transportin detar dhe në përgatitjen e sektorit për kërkesat e ardhshme të legjislacionit evropian mbi klimën dhe mjedisin.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Transporti Detar është një nga fushat kryesore të kapitullit të transportit. Për këtë arsye, në PKIE 2024-2026, tek aktet e kapitullit 14 “Politikat e Transportit”, është planifikuar edhe miratimi i projektvendimit “Për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazeve serrë nga transporti detar” brenda vitit 2026.

Miratimi i këtij projektvendimi nuk është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektvendimi parashikon krijimin e një sistemi të standardizuar për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazeve serrë nga transporti detar. Ky proces rrit transparencën e të dhënave, forcon besueshmërinë e statistikave kombëtare për sektorin detar dhe mundëson një bazë të qartë për politikat e ardhshme të reduktimit të shkarkimeve. Këto elemente rrisin konkurrueshmërinë e sektorit detar shqiptar, duke e përafruar me standardet ndërkombëtare dhe duke nxitur investime në teknologji të pastra dhe efikasitet energjetik.

Efektet e pritshme janë reduktimi gradual i shkarkimeve të gazeve serrë, përmirësimi i performancës energjetike të flotës tregtare dhe përmbushja e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e klimës. Rregullorja do të ndihmojë në krijimin e një tregu të transportit detar më të qëndrueshëm dhe konkurrues, duke mbrojtur mjedisin detar dhe duke kontribuar në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi hartohet në mbështetje të Ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Për Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr. 155, dt. 17.12.2020 “Për ndryshimet klimatike” të ndryshuar, të ligjit Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre anëtare që parashikojnë përafrimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, veçanërisht në rritjen e transparencës mbi ndikimin e sektorit detar në ndryshimet klimatike, si dhe të vendimit nr. 13, datë 11.1.2017 “Për miratimin e rregullores “Për kontrollin shtetëror portual në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNITAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi është në përputhje të plotë me legjislacionin evropian, konkretisht me rregulloren 2015/757/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 29 Prill 2015, “Për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazeve serrë nga transporti detar”. Akti përfaqëson një përafrim të plotë të rregullores, përjashtuar ato dispozita që janë të aplikueshme ekskluzivisht për shtetet anëtare të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi synon miratimin e rregullores “Për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazeve serrë nga transporti detar”, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor kombëtar në fushën e transportit detar dhe ndryshimeve klimatike, si dhe në funksion të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Fusha e zbatimit të rregullores përfshin anijet që kryejnë transport tregtar mallrash dhe pasagjerësh, me tonazh bruto 400 GT dhe mbi 400 GT, për udhëtimet që realizohen drejt, nga ose ndërmjet porteve të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe anijet në det të hapur (offshore). Gjithashtu, rregullorja përcakton gazet serrë që mbulohen nga monitorimi, konkretisht dioksidin e karbonit (CO₂), metanin (CH₄) dhe protoksidin e azotit (N₂O).

Projektakti përcakton detyrimet e kompanive detare për monitorimin e shkarkimeve të gazeve serrë për secilën anije nën përgjegjësinë e tyre, përmes zbatimit të planeve të monitorimit të verifikuara nga subjekte të akredituara dhe të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare. Në këtë kuadër, kompanitë detyrohen të sigurojnë mbledhjen, regjistrimin dhe raportimin e plotë, transparent dhe të krahasueshëm të të dhënave përkatëse, si dhe të garantojnë integritetin dhe saktësinë e tyre.

Rregullorja parashikon gjithashtu rolin e verifikuesve të akredituar për vlerësimin e konformitetit të planeve të monitorimit dhe të raporteve të shkarkimeve, si dhe procedurat për lëshimin e dokumentit të përputhshmërisë për anijet që përmbushin kërkesat e përcaktuara. Në funksion të zbatimit të saj, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Detare, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas kompetencave përkatëse institucionale.

Miratimi i këtij projektakti kontribuon në forcimin e mekanizmave kombëtarë për monitorimin e shkarkimeve të gazeve serrë në sektorin detar, në rritjen e transparencës dhe raportimit të të dhënave mjedisore, si dhe në përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare dhe të procesit të integritetit evropian në fushën e transportit dhe mjedisit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Detare, e cila miraton planet e monitorimit të paraqitura nga kompanitë detare dhe i përcjell Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, vendimet, planin e monitorimit dhe raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve GES, AKM-ja si institucioni përgjegjës për hartimin e raportit mbi zbatimin e kërkesave për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të GES-eve të kompanive të transportit detar si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e cila është përgjegjëse për akreditimin e verifikuesve që do të vlerësojnë planet e monitorimit dhe raportet e emetimeve të kompanive të transportit detar.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT VENDORIT

Projektvendimi është përgatitur nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës së Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim ngre sistemin për monitorimin dhe raportimin (MRV) e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë në përputhje me standardet e BE-së, duke plotësuar mangësitë ligjore dhe teknike ekzistuese në legjislacionin shqiptar. Për shkak të rrisë së sistemit MRV që tashmë do të jetë në linjë me rregullat dhe metodologjinë teknike të BE-së, projektvendimi sjell ndikime financiare si për buxhetin e shtetit ashtu dhe për sektorin privat.

1. Kostot për buxhetin e shtetit

Ky projektvendim nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucioneve të saj të varësisë, pasi Drejtoria e Përgjithshme Detare disponon kapacitetet institucionale dhe burimet njerëzore të nevojshme për zbatimin e tij. Në strukturën e saj është i përfshirë eksperti përgjegjës për çështjet mjedisore që lidhen me zbatimin e Konventës MARPOL, i cili do të ofrojë ekspertizën teknike në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të planit të monitorimit dhe raportit të shkarkimeve të gazeve serrë

2. Kostot për sektorin privat

Zbatimi i detyrimeve MRV nga kompanite detare do të sjellë disa kosto për këtë sektor, të cilët do të nisin të zbatojnë për herë të parë sistemin MRV sipas standardeve dhe metodologjisë së BE-së.

Ky sektor do të ketë kosto për hartimin e planit të monitorimit dhe raportit të të dhënave të monitorimit si dhe për ndërveprimin me institucionet kompetente: Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Verifikuesit e Akredituar, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrinë e Mjedisit. Parashikohet nevoja e punësimit të të paktën një punonjësi teknik për kryerjen e këtyre funksioneve në një kosto të përafërt prej 1.300.000 – 1.500.000 Lekë në vit. Megjithatë jo në të gjitha rastet mund të lindë nevoja për staf shtesë, pasi një pjesë e konsiderueshme e operatorëve, kanë aktualisht stafin teknik përkatës (ekspert mjedisor) me kapacitete të mjaftueshme ose që mund të përfitojnë nga trajnimet që do të organizohen nga institucionet shtetërore, për të kryer detyrat funksionale të monitorimit dhe raportimit të shkarkimeve.

MINISTËR I MJEDISIT

SOFJAN JAUPAJ

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

ENEA KARAKAÇI

**MINISTER
DELINA IBRAHIMAJ**